



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

REPUBLIKA E KOSOVËS GJYKATA THEMELORE		REPUBLIKA KOSOVA OSNOVNI SUD
G.J.A-S.U.A	05/2025	
Dt:	14.01.2025	
GJILAN - GNJILANE		

14 janar 2025

Raporti vjetor i punës

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Janar – Dhjetor 2024

Bazuar në nenin 14, pika 2 nën pika 2.4 të Ligjit për Gjykatat, Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan paraqet raportin e rregullt të punës.

Raporti i rregullt i punës së Gjykatës Themelore në Gjilan përfshinë periudhën raportuese nga 1 janar deri më 31 dhjetor 2024.

I. Hyrje

Raporti i Gjykatës Themelore të Gjilanit paraqet të gjitha të dhënat statistikore për këtë periudhë, të arriturat, sfidat, por edhe pengesat që kanë qenë gjatë kësaj periudhe.

Ky raport është i bazuar në detyrat dhe objektivat e projektuara dhe të përcaktuara paraprakisht me Planin Vjetor të Punës, Planet Periodike dhe Planin Strategjik Operativ të Gjykatës.

II. Struktura e Gjykatës Themelore në Gjilan me Degët e saja

Në Gjykatën Themelore të Gjilanit së bashku me Degët, Kamenicë, Viti dhe Novobërdë, janë gjithsejtë 33 gjyqtarë (përfshirë edhe kryetarin e gjykatës), të caktuar në departamente dhe divizione, por gjatë këtij viti kanë shkuar në pension 3 gjyqtarë, një është transferuar, një gjyqtar ka pezulluar punën, kurse kemi pranuar me transfer 2 gjyqtarë dhe një gjyqtare akoma gjendet në trajnim fillestar.

Gjykata Themelore në Gjilan, ka punuar me 22 gjyqtarë (përfshirë edhe kryetarin e gjykatës).

Në Departamentin e Krimeve të Rënda gjatë vitit 2024 kanë qenë 5 gjyqtarë, në Departamentin për të Mitur ka gjykuar 1 gjyqtar, ndërsa në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal kanë gjykuar 3 gjyqtarë, në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil kanë gjykuar 9 gjyqtarë (7 gjyqtarë nga fillimi, ndërsa 2 nga muajit tetor), dhe në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Kundërvajtjes kanë gjykuar 2 gjyqtarë.

Dega e Gjykatës Themelore në Kamenicë: Në këtë degë gjatë vitit 2024 kanë gjykuar 3 gjyqtarë (2 civile, 1 penale), kurse në lëminë civile është ndihmuar edhe nga me 3 gjyqtarë nga qendra edhe atë nga shtatori i vitit 2024.

Dega e Gjykatës Themelore në Viti: Në këtë degë gjatë vitit 2024 kanë gjykuar 7 gjyqtarë (1 penale, 6 civile), deri në shtator të vitit 2024, ku njëri është transferuar në gjykatë tjetër. Kësaj dege gjatë gjithë vitit i kanë ndihmuar të gjithë gjyqtarët e DKR-së në lëminë penale, kurse gjyqtarët nga Departamenti i Përgjithshëm i kanë ndihmuar 3 gjyqtarë, 2 prej tyre në kundërvajtje, kurse njëri në lëminë penale. Kurse nga muaji tetor nga kjo Degë është ngarkuar një gjyqtarë me lëndë civile kontestimore të qendrës.


Dega e Gjykatës Themelore në Novobërdë: Në këtë degë kanë gjykuar 2 gjyqtarë në lëminë civile, ndërsa lëndë penale dhe ato të kundërvajtjes është deleguar që të gjykoj një gjyqtar nga Dega e Kamenicës.

Në Gjykatën Themelore të Gjilanit, lëndët ndahen me Sistemin e Programit SMIL, ashtu siç është caktuar me Rregulloren mbi veprimtarinë e gjykatave.


III. Raportet statistikore

Të dhënat statistikore të paraqitura në grafikona dhe formë tabelare të cilat janë të nxjerra nga Programi SMIL.


Efikasiteti në përqindje (%) i Gjykatës së bashku me Degët




Efikasiteti në % i Gjykatës Themelore Gjilan me Degë



GJYKATA THEMELORE GJILAN






Gjykata Themelore Gjilan	Lëmia	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zafidhura</u>
		I	<u>II</u>	III	<u>IV</u>	V	<u>II - IV</u>
Dep. Krimeve të Rënda	Paraprake	263	<u>178</u>	441	<u>148</u>	293	<u>83 %</u>
	Penale	458	<u>166</u>	634	<u>197</u>	436	<u>119 %</u>
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	489	<u>231</u>	720	<u>193</u>	527	<u>84 %</u>
	Penale	1334	<u>944</u>	2278	<u>913</u>	1365	<u>97 %</u>
	Civile	5045	<u>6711</u>	11768	<u>7049</u>	4718	<u>105 %</u>
	Jashtëkontestimore	146	<u>239</u>	385	<u>223</u>	162	<u>93 %</u>
	Përmbarrimore	323	<u>148</u>	471	<u>200</u>	271	<u>135 %</u>
Dep. për të Mitur	Përgatitore për të mitur	29	<u>12</u>	41	<u>8</u>	33	<u>67 %</u>
	Penale para kolegjit	130	<u>106</u>	236	<u>107</u>	129	<u>101 %</u>
Divizioni Kundërvajtjes	Kundërvajtje	1801	<u>1580</u>	3381	<u>1906</u>	1475	<u>121 %</u>
	TOTALI	10028	<u>10315</u>	20355	<u>10944</u>	9409	<u>106 %</u>


Vërejtje: Sa i përket procedurës paraprake si në DKR, DM dhe DP statistikave e prezantuara në % nuk janë të sakta për faktin se të gjithë lëndët në procedurën paraprake janë të përfunduara, por në sistemin SMIL regjistrohen këto të dhëna dhe në vazhdimësi bëjmë përpjekje të eliminojmë këto gabime teknike të bëra nga zyrtarët e gjykatës tonë.

DEGA E GJYKATËS THEMELORE KAMENICË




Dega e Themelores Kamenicë	Lëmia	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zafidhura</u>
		I	<u>II</u>	III	<u>IV</u>	V	<u>II - IV %</u>
	Paraprake	84	<u>78</u>	162	<u>61</u>	101	<u>78 %</u>
	Penale	136	<u>181</u>	317	<u>167</u>	150	<u>92 %</u>
	Civile	1592	<u>1304</u>	2905	<u>2080</u>	825	<u>160 %</u>
	Jashtëkontestimore	47	<u>13</u>	60	<u>34</u>	26	<u>262 %</u>
	Përmbarimore	89	<u>50</u>	139	<u>89</u>	50	<u>178 %</u>
	Kundërvajtje	382	<u>400</u>	782	<u>328</u>	454	<u>82 %</u>
TOTALI		2330	<u>2026</u>	4365	<u>2759</u>	1606	<u>136 %</u>

DEGA E GJYKATËS THEMELORE VITI



Dega e Themelores Viti	Lëmia	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura</u> <u>II – IV %</u>
		I	<u>II</u>	III	<u>IV</u>	V	
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	62	<u>129</u>	191	<u>104</u>	88	<u>81 %</u>
	Penale	1218	<u>486</u>	1704	<u>867</u>	837	<u>178 %</u>
	Civile	2737	<u>1878</u>	4615	<u>2666</u>	1949	<u>142 %</u>
	Jashtëkontestimore	36	<u>23</u>	59	<u>30</u>	29	<u>130 %</u>
	Përmbarimore	287	<u>308</u>	595	<u>122</u>	473	<u>40 %</u>
	Kundërvajtje	956	<u>606</u>	1562	<u>881</u>	681	<u>145 %</u>
TOTALI		5297	<u>3430</u>	8727	<u>4670</u>	4057	<u>136 %</u>

DEGA E GJYKATËS THEMELORE NOVOBËRDË



Dega e Themelores Novobërdë	Lëmia	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zafidhura</u>
		I	<u>II</u>	III	<u>IV</u>	V	<u>II - IV %</u>
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	12	<u>4</u>	16	<u>2</u>	14	<u>50 %</u>
	Penale	134	<u>96</u>	230	<u>84</u>	146	<u>88 %</u>
	Civile	330	<u>246</u>	576	<u>240</u>	336	<u>98 %</u>
	Jashtëkontestimore	62	<u>30</u>	92	<u>55</u>	37	<u>137 %</u>
	Përmbarrimore	34	<u>61</u>	95	<u>49</u>	46	<u>80 %</u>
Divizioni Kundërvajtjes	Kundërvajtje	158	<u>187</u>	345	<u>150</u>	195	<u>80 %</u>
TOTALI		730	<u>624</u>	1354	<u>580</u>	774	<u>93 %</u>

IV. Përmbushja e objektivave

Zvogëlimi i ngarkesës së lëndëve për gjyqtarë dhe ndarja e tyre: gjatë vitit 2024, kemi bërë përpjekje që të inkurajojmë sa ma tepër gjyqtarët që të njëjtit të caktojnë dhe përfundojnë lëndët sa më shumë që është e mundur në të gjitha departamentet dhe divizionet dhe mund të konsiderojmë se është punuar më tepër se në vitin paraprak dhe konsiderojmë që kemi pasur sukses në zvogëlimin e numrit të lëndëve, si në aspektin numerik, por edhe përfundimin e lëndëve sipas strategjive të KGJK-së.

Gjatë vitit 2024 siç e kemi paraparë në Plan të Punës kemi arritur që ti barazojmë gjyqtarët me ngarkesën e tyre ku pothuajse të gjithë gjyqtarët janë të ngarkuar njësoj (+/- 20-30 lëndë).

Sa i përket Departamentit të Përgjithshëm - Divizioni Penal gjyqtarët janë munduar që të përfundojnë lëndë të këtij divizioni, por mungesa e prokurorëve e ka vështirësuar punën. Sa i përket Departamentit të Krimeve të Rënda konsideroj se gjatë vitit 2024 gjyqtarët në këtë departament kanë përfunduar lëndë, por të njëjtit kanë gjykuar edhe lëndë të DP – Divizioni Penal të qendrës dhe të Degës së Vitisë.

Gjithashtu gjatë vitit 2024 është mbështetur edhe Dega e Gjykatës në Kamenicë me gjyqtar, me bashkëpunëtor profesional, me përkthyes dhe me zyrtar ligjor.

Nga gjithë gjyqtarët të kësaj gjykate është kërkuar që të rrisin efikasitetin, të jenë transparent, të trajtojnë lëndët në bazë të parimit të arritjes në Gjykatë dhe lëndët me prioritet ligjor, lëndët e vjetra, lëndët rigjykimin ti angazhojnë sa më tepër bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtaret ligjore që i kanë në dispozicion, e çka konsiderojmë që gjatë këtij viti kemi bërë një punë të kënaqshme, në raport me vitet paraprake edhe përkundër faktit se kemi punuar me më pak gjyqtarë dhe bashkëpunëtorë profesional.

Si e arritur tjetër mund të konsiderojmë që kemi rritur transparencën e gjykatës në raport me qytetarët, shoqërinë civile, mediat, institucionet ku gjatë vitit 2024 kemi pranuar në takim shumë qytetarë, kemi dëgjuar hallet dhe problemet e tyre, kemi bashkëpunuar me organizata të ndryshme, kemi pasur pyetje të vazhdueshme nga mediat dhe nga monitoruesit ku të gjithave pyetjeve ju kemi përgjigjur me kohë rekord, e gjithashtu kemi pasur kërkesa për qasje në dokumente publike.

Sa i përket publikimit të aktgjykimeve, gjatë vitit 2024 Udhëheqësi i Zyrës për Informim së bashku me bashkëpunëtorët profesional dhe stafin tjetër mbështetës ka arritur të publikojë 5028 vendime gjyqësore në ueb faqen e gjykatës.

V. Sfidat e paraqitura

Si sfidë e kësaj gjykate gjatë vitit 2024 ka qenë lëndët e ardhura në Divizionin Civil, ku ka pasur një numër të konsiderueshëm në raport me vitin paraprak, por siç thamë më lartë kemi përfunduar edhe shumë më tepër lëndë në krahasim me vitin paraprak.

Në sfidat i kemi paraqitur në çdo tremujor dhe gjatë gjithë vitit 2024 pothuajse kanë qenë sfida të njëjta që i kemi paraqitur, por sido që të jetë në pika të shkurtra do të i përmendim më poshtë:

Një sfidë mbetet edhe mungesa e stafit administrativ (zyrtarët ligjore – sekretaret juridike, bashkëpunëtorë profesional), pasi që disa sekretare juridike janë në moshë të shtyrë dhe kanë probleme me shëndetin, me përdorimin e teknologjisë, kurse gjatë këtij viti 4 bashkëpunëtorë profesional kemi pasur në pushim të lehonisë;

Për Gjykatën Themelore në Gjilan së bashku me degët nevojë urgjente mbetet plotësimi me gjyqtarë shtesë si në qendër ashtu edhe nëpër degë, pasi që gjatë vitit 2024 në këtë Gjykatë janë pensionuar 3 gjyqtarë, një gjyqtarë është transferuar dhe një gjyqtarë ka pezulluar punën;

Një sfidë tjetër për lëndët penale është mungesa e prokurorëve si në qendër ashtu edhe në Degët Kamenicë, Viti dhe Novobërdë, ku ka mungesë të theksuar të prokurorëve dhe për këtë çështje disa herë kam takuar Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ku i njëjti na ka njoftuar se pa u bërë plotësimi i vendeve të lira në këtë prokurori nuk mund të përmirësohet gjendja, sido që të jetë ka pas përpjekje për të na ndihmuar me qëllim që mos të shtyhen seancat;

Sa i përket Sistemit SMIL, ne më lartë i kemi paraqitur statistikën, por të njëjtat nuk janë të sakta sa i përket ngarkesës së gjyqtarëve dhe gjykatës në përgjithësi dhe në vazhdimësi me zyrtari të SMIL-it dhe personat përgjegjës të SKGJK-së kemi bërë përpjekje të eliminojmë këto gabime në raporte statistikore dhe gabime të tjera, por deri në këtë momente nuk kemi arritur;

Si sfidë e kësaj Gjykate gjatë vitit 2024, ka qenë edhe disiplinimi i stafit administrativ, por konsideroj që në raport me vitin paraprak kemi arritur sukses të theksuar në raport me disiplinimin e stafit administrativ dhe gjatë vitit 2024 konsideroj që kemi qenë në rregull përjashtimit ndonjë rasti jo serioz;

Sa i përket teknologjisë kemi mungesë të printerëve funksional, nëpër zyre të stafit (gjyqësore dhe administrativ), gjithashtu ka probleme të vazhdueshme edhe nëpër salla të gjykimeve me printerë ku shumë herë kemi kërkuar nga kompania që i mirëmban që të intervenojë në sanimin e këtyre problemeve.

VI. Të arriturat

Gjatë vitit 2024 kemi shënuar rezultate në të gjitha departamentet - divizionet në raport me vitin e 2023 dhe gjatë gjithë kohës kemi bërë përpjekje maksimale së bashku me mbikëqyrësit dhe të gjithë gjyqtarët që të përfundohen sa më tepër lëndë, kemi barazuar gjyqtarët me ngarkesë si ata në qendër në raport me ata të degëve, kemi ndihmuar degët e gjykatës, në veçanti atë të Vitisë dhe Kamenicës me gjyqtarë, bashkëpunëtorë profesional, përkthyes.

Gjithashtu kemi arritur që në qendër lëndët civile kontestimore ti përfundojmë ato lëndë të cilët kanë arritur në gjykatë deri në vitin 2022; të përfundojnë lëndë të vjetra në lëminë civile, lëndë të rigjykimit, lëndë me prioritet ligjor, ku gjatë vitit 2024 kemi vendosur një standard që lëndët statusore, lëndët e pengim posedimit dhe lëndët nga kontestet e punës të caktohen në afatin 3 mujor nga dita kur ka arritur lënda në Gjykatë.

Gjithashtu, konsiderojmë që gjatë vitit 2024 kemi arritur të ngrisim përgjegjësinë dhe llogaridhënien e gjyqtarëve, pasi që në shumicën e rasteve lëndët e rigjykimit janë caktuar në afatin ligjor, lëndët me prioritet ligjor janë caktuar me urgjencë dhe në ato raste kur nuk është vepruar në këtë mënyrë kemi paraqitur raste pranë komisioni disiplinor.

Sa i përket stafit mbështetës dhe administrativ kemi arritur që të ngrisim nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies dhe gjatë vitit 2024 nuk kemi pasur ndonjë rast që ndonjë zyrtar të mos respektoj orarin, vendin e punës dhe detyrat e punës, me një fjalë të gjithë zyrtarët kanë qenë më të përgjegjshëm në ushtrimin e detyrave të tyre në raport me vitet e tjera.

VII. Përfundimi

Në bazë të dhënave statistikore mund të jemi i kënaqur, pasi që nga statistikat mund të vijmë në përfundim se jemi gjykata e parë në nivel vendi me lëndë të përfunduara, por siç thash më lartë në vazhdimësi bëjmë përpjekje, kërkojmë, bisedojmë që stafi administrativ të jetë më efektiv (të respektoj orarin e punës, vendin e punës dhe detyrat e punës), kurse sa i përket gjyqtarëve nga të njëjtit në vazhdimësi kam kërkuar që të caktojnë – procedojnë lëndë sa më tepër që është e mundur, të caktojnë lëndët e rigjykimit dhe të trajtojnë çështjes sipas arritjes në gjykatë dhe konsiderojë që në vitin 2025 do të ketë edhe më tepër rezultate për përfundimin e lëndëve se sa për vitin që po raportojmë.

Sa i përket, transparencës, llogaridhënies, objektivitetit, paanshmërisë dhe pavarësisë, unë në vazhdimësi kërkojë nga gjyqtarët dhe të njëjtit i inkurajoj që të jenë të pavarur dhe të paanshëm në trajtimin e çështjeve dhe

profesional, pasi që kthimi i besimit në sistemin e drejtësisë është njëri ndër objektivat i yni kryesor së bashku me llogaridhënien, përgjegjësinë dhe ngritjen e efikasitetit dhe kjo mund të arrihet me punë dhe angazhim maksimal, duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi nga gjithë punonjësit e kësaj gjykate.

Venhar Salihu _____

Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan

IV. Përmbushja e objektivave

Zvogëlimi i ngarkesës së lëndëve për gjyqtarë dhe ndarja e tyre: gjatë vitit 2024, kemi bërë përpjekje që të inkurajojmë sa më tepër gjyqtarët që të njëjtit të caktojnë dhe përfundojnë lëndët sa më shumë që është e mundur në të gjitha departamentet dhe divizionet dhe mund të konsiderojmë se është punuar më tepër se në vitin paraprak dhe konsiderojmë që kemi pasur sukses në zvogëlimin e numrit të lëndëve, si në aspektin numerik, por edhe përfundimin e lëndëve sipas strategjive të KGJK-së.

Gjatë vitit 2024 siç e kemi paraparë në Plan të Punës kemi arritur që ti barazojmë gjyqtarët me ngarkesën e tyre ku pothuajse të gjithë gjyqtarët janë të ngarkuar njësoj (+/- 20-30 lëndë).

Sa i përket Departamentit të Përgjithshëm - Divizioni Penal gjyqtarët janë munduar që të përfundojnë lëndë të këtij divizioni, por mungesa e prokurorëve e ka vështirësuar punën. Sa i përket Departamentit të Krimeve të Rënda konsideroj se gjatë vitit 2024 gjyqtarët në këtë departament kanë përfunduar lëndë, por të njëjtit kanë gjykuar edhe lëndë të DP – Divizioni Penal të qendrës dhe të Degës së Vitisë.

Gjithashtu gjatë vitit 2024 është mbështetur edhe Dega e Gjykatës në Kamenicë me gjyqtar, me bashkëpunëtor profesional dhe me përkthyes.

Nga gjithë gjyqtarët të kësaj gjykate është kërkuar që të rrisin efikasitetin, të jenë transparent, të trajtojnë lëndët në bazë të parimit të arritjes në Gjykatë dhe lëndët me prioritet ligjor, lëndët e vjetra, lëndët rigjykimin ti angazhojnë sa më tepër bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtaret ligjore që i kanë në dispozicion, e çka konsiderojmë që gjatë këtij viti kemi bërë një punë të kënaqshme, në raport me vitet paraprake edhe përkundër faktit se kemi punuar me më pak gjyqtarë dhe bashkëpunëtorë profesional.

Si e arritur tjetër mund të konsiderojmë që kemi rritur transparencën e gjykatës në raport me qytetarët, shoqërinë civile, mediat, institucionet ku gjatë vitit 2024 kemi pranuar në takim shumë qytetarë, kemi dëgjuar problemet e tyre në lidhje me lëndët dhe ku ka pasur hapësirë kemi marr veprimet sipas kompetencës, kemi bashkëpunuar me organizata të ndryshme, kemi pasur pyetje të vazhdueshme nga mediat dhe nga monitoruesit ku të gjithave pyetjeve ju kemi përgjigjur me kohë rekord, e gjithashtu kemi pasur kërkesa për qasje në dokumente publike.

Sa i përket publikimit të aktgjykimeve, gjatë vitit 2024 Udhëheqësi i Zyrës për Informim së bashku me bashkëpunëtorët profesional dhe stafin tjetër mbështetës ka arritur të publikojë 5028 vendime gjyqësore në ueb faqen e gjykatës.

V. Sfidat e paraqitura

Si sfidë e kësaj gjykate gjatë vitit 2024 ka qenë lëndët e ardhura në Divizionin Civil, ku ka pasur një numër të konsiderueshëm në raport me vitin paraprak, por siç thamë më lartë kemi përfunduar edhe shumë më tepër lëndë në krahasim me vitin paraprak.

Ne sfidat i kemi paraqitur në çdo tremujor dhe gjatë gjithë vitit 2024 pothuajse kanë qenë sfida të njëjta që i kemi paraqitur, por sido që të jetë në pika të shkurtra do të i përmendim më poshtë:

Një sfidë mbetet edhe mungesa e stafit administrativ (zyrtarët ligjore – sekretaret juridike, bashkëpunëtorë profesional), pasi që disa sekretare juridike janë në moshë të shtyrë dhe kanë probleme me shëndetin, me përdorimin e teknologjisë, kurse gjatë këtij viti 4 bashkëpunëtorë profesional kemi pasur në pushim të lehonisë;

Për Gjykatën Themelore në Gjilan së bashku me degët nevojë urgjente mbetet plotësimi me gjyqtarë shtesë si në qendër ashtu edhe nëpër degë, pasi që gjatë vitit 2024 në këtë Gjykatë janë pensionuar 3 gjyqtarë, një gjyqtarë është transferuar dhe një gjyqtarë ka pezulluar punën;

Një sfidë tjetër për lëndët penale është mungesa e prokurorëve si në qendër ashtu edhe në Degët Kamenicë, Viti dhe Novobërdë, ku ka mungesë të theksuar të prokurorëve dhe për këtë çështje disa herë kam takuar Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ku i njëjti na ka njoftuar se pa u bërë plotësimi i vendeve të lira në këtë prokurori nuk mund të përmirësohet gjendja, sido që të jetë ka pas përpjekje për të na ndihmuar me qëllim që mos të shtyhen seancat;

Sa i përket Sistemit SMIL, ne më lartë i kemi paraqitur statistikën, por të njëjtat nuk janë të sakta sa i përket ngarkesës së gjyqtarëve dhe gjykatës në përgjithësi dhe në vazhdimësi me zyratari i SMIL-it dhe personat përgjegjës të SKGJK-së kemi bërë përpjekje të eliminojmë këto gabime në raporte statistikore dhe gabime të tjera, por deri në këtë moment nuk kemi arritur;

Si sfidë e kësaj Gjykate gjatë vitit 2024, ka qenë edhe disiplinimi i stafit administrativ, por konsideroj që në raport me vitet paraprake kemi arritur sukses dhe rezultate të theksuara në raport me disiplinimin e stafit administrativ dhe gjatë vitit 2024 konsideroj që kemi qenë në rregull përjashtimit ndonjë rasti jo serioz;

Sa i përket teknologjisë kemi mungesë të printerëve funksional, nëpër zyre të stafit (gjyqësore dhe administrativ), gjithashtu ka probleme të vazhdueshme edhe nëpër salla të gjykimeve me printerë ku shumë herë kemi kërkuar nga kompania që i mirëmban që të intervenojë në sanimin e këtyre problemeve.

VI. Të arriturat

Gjatë vitit 2024 kemi shënuar rezultate në të gjitha departamentet - divizionet në raport me vitin e 2023 dhe gjatë gjithë kohës kemi bërë përpjekje maksimale së bashku me mbikëqyrësit dhe të gjithë gjyqtarët që të përfundohen sa më tepër lëndë, kemi barazuar gjyqtarët me ngarkesë si ata në qendër në raport me ata të degëve, kemi ndihmuar degët e gjykatës, në veçanti atë të Vitisë dhe Kamenicës me gjyqtarë, bashkëpunëtorë profesional, përkthyes.

Gjithashtu kemi arritur që në qendër lëndët civile kontestimore ti përfundojmë ato lëndë të cilët kanë arritur në gjykatë deri në vitin 2022; dhe në këtë vit kemi caktuar dhe futur në punë lëndë të ardhura gjatë vitit 2023 dhe 2024, të përfundojnë lëndë të vjetra në lëminë civile, lëndë të rigjykimit, lëndë me prioritet ligjor, ku gjatë vitit 2024 kemi vendosur një standard që lëndët statusore, lëndët e pengim posedimit dhe lëndët nga kontestet e punës të caktohen në afatin 3 mujor nga dita kur ka arritur lënda në Gjykatë.

Gjithashtu, konsiderojmë që gjatë vitit 2024 kemi arritur të ngrisim përgjegjësinë dhe llogaridhënien e gjyqtarëve, pasi që në shumicën e rasteve lëndët e rigjykimit janë caktuar në afatin ligjor, lëndët me prioritet ligjor janë caktuar me urgjencë dhe në ato raste kur nuk është vepruar në këtë mënyrë kemi paraqitur raste pranë komisioni disiplinor.

Sa i përket stafit mbështetës dhe administrativ kemi arritur që të ngrisim nivelin e përgjegjesisë dhe llogaridhënies dhe gjatë vitit 2024 nuk kemi pasur ndonjë rast që ndonjë zyrtar të mos respektoj orarin, vendin e punës dhe detyrat e punës, me një fjalë të gjithë zyrtarët kanë qenë më të përgjegjshëm në ushtrimin e detyrave të tyre në raport me vitet e tjera.

VII. Përfundimi

Në bazë të dhënave statistikore mund të jemi i kënaqur, pasi që nga statistikat mund të vijmë në përfundim se jemi gjykata e parë në nivel vendi me më shumë lëndë të përfunduara, por siç thash më lartë në vazhdimësi bëjmë përpjekje, kërkojmë, bisedojmë që stafi administrativ të jetë më efektiv (të respektoj orarin e punës, vendin e punës dhe detyrat e punës), kurse sa i përket gjyqtarëve nga të njëjtit në vazhdimësi kam kërkuar që të caktojnë – procedojnë lëndë sa më tepër që është e mundur, të caktojnë lëndët e rigjykimit dhe të trajtojnë çështjes sipas arritjes në gjykatë dhe konsiderojë që në vitin 2025 do të ketë edhe më tepër rezultate për përfundimin e lëndëve se sa për vitin që po raportojmë.

profesional, pasi që kthimi i besimit në sistemin e drejtësisë është njëri ndër objektivat i yni kryesor së bashku me llogaridhënien, përgjegjësinë dhe ngritjen e efikasitetit dhe kjo mund të arrihet me punë dhe angazhim maksimal, duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi nga gjithë punonjësit e kësaj gjykate.

Venhar Salihu

Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan